



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”



Tiranë, shtator 2025

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|-------------|--|--------------|
| I. | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit | 4 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | 4 |
| 3. | Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit | 8 |
| II. | HYRJA | |
| 1. | Objektivat dhe qëllimi i auditimit | 8 |
| 2. | Identifikimi i çështjes | 8 |
| 3. | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar | 8 |
| 4. | Përgjegjësitë e audituesve | 8 |
| 5. | Kriteret e vlerësimit | 9 |
| 6. | Standardet e auditimit | 9 |
| 7. | Metodat e auditimit | 9 |
| 8. | Dokumentimi i auditimit | 9 |
| III. | PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | |
| 1. | Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim | 10 |
| 2. | Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit | |
| 2.1 | Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK | 10-15 |
| 2.2 | Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit | 15-33 |
| IV. | REKOMANDIME | 34-40 |

LISTA E SHKURTIMEVE

| Shkurtimi | Emërtimi i plotë |
|------------------|--|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| GjShPJPSH | Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër |
| KLGG | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| RSh | Republika e Shqipërisë |
| QTI | Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë |
| AKCESK | Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike |
| ICMIS | Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore |
| TI(IT) | Teknologjia e Informacionit |
| TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| RDAS | Regjistrimi Dixhital Audio |
| GMCÇ | Grupi i Menaxhimit të Çështjes |
| PC | Kompjuter Personal |
| BMS | Building Management System |
| CMS | Content Management System |
| AD | Active Directory |
| ISO | International Organization for Standardization |
| COBIT | Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (GjShPJPSH), nga data 20.03.2025 deri në 16.05.2025.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në GjShPJPSH, është pjesë e Planit Vjetor 2025 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në GjShPJPSH.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 272/1, me datë 20.03.2025.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka të hartuar dhe miratuar rregullore të brendshme në të cilën të përcaktohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë institucionale, si dhe detyrat funksionale të punonjësve duke përfshirë edhe teknologjinë e informacionit, kjo jo në përputhje me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”.

- Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka miratuar një strategji institucionale, si dhe nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Mungesa e strategjisë sjell pasoja dhe rreziqe të ndryshme, në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve, përdorimit joefikas të burimeve njerëzore, humbje të besimit nga qytetarët, humbjes së vizionit afatgjatë, etj.

Gjithashtu, u konstatua se Teknologjia e Informacionit dhe përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. GjShPJPSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave që normojnë proceset e teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore rregullat dhe politikat e përgjithshme si dhe praktikat më të mira.

- Nga auditimi i funksionaliteteve të roleve në sistemin ICMIS konstatohet se:

- Nuk ekziston një përdorues/rol në sistem me qëllim gjenerimin e statistikave përkatëse nga sistemi që gjykata raporton në KLGJ apo institucione të tjera. Konstatohet se sektori i statistikave përdor user-in e ‘sekretares’ me qëllim gjenerimin e statistikave nga sistemi ose

statistikat për gjykatën i realizon manualisht në raste kur ka diferenca ose mos koordinim me sistemin;

- Fushat të cilat nuk janë të detyrueshme për tu plotësuar pothuajse në shumicën e rasteve janë lënë bosh, si për çështjet që regjistrohen ashtu dhe për të dhënat e secilit përdorues të sistemit duke lënë hapësirë për mos përdorimin e sistemit me të gjitha funksionalitetet e krijuara në të;

- Data e largimit të punonjësve të cilët janë larguar nga gjykata është lënë e paplotësuar për të gjithë punonjësit e larguar, për shkak se sistemi nuk identifikon më çështjet e trajtuar nga ai punonjës dhe të gjitha çështjet e atij përdoruesi nuk gjenerohen më nga sistemi;

- Roli 'Arkivit' nuk përdoret nga asnjë punonjës i gjykatës;

- Tek opsioni i Akuzave, ka akuza të cilat sistemi nuk i ka të regjistruara me qëllim selektimin e tyre, e për pasojë shtohen nga regjistruesja manualisht me komentin përkatës;

- Tek sesioni 'Kategoria e Çështjes' nuk është shtuar opsioni 'I mitur në konflikt me Ligjin' në sistem, ky opsion shtohet më pas manualisht tek sesioni 'Palët';

- Ekzistojnë opsione të cilat nuk kryejnë asnjë funksion në sistem si prsh., 'Numër Akti Regjistër', ose Opsione në modulet kryesore si:

- Moduli 'Administrimi' ka sesione të cilat nuk përdoren si: 'Mesazhe Specifike', 'Ditë Pushimi', 'Lejet e Punonjësve', 'Eksport', 'Kërkim në Serverin Qendror', 'Transfero në Serverin Qendror' dhe 'Anullo Mbartje';

- Moduli 'Përcakto' ka sesione të cilat nuk përdoren si: 'Lista e Kontrollit', 'Mesazhe' dhe 'Numërtimi i Vendimeve'.

- Asnjë nga çështjet e trajtuara në sistem nuk arkivohen dhe nuk shfaqet asnjë informacion për statusin e çështjeve 'të arkivuara'.

- Moduli 'Arkiva e çështjeve' nuk funksionon si dhe shfaq informacionin 'Gabim i paparashikuar. Ju lutem mos bëni asnjë veprim...';

- Vendimet të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi nuk janë sipas formateve të vendimit, duke kërkuar kryerjen e veprimeve manualisht me qëllim minimizimin e gabimeve sipas formatit që gjeneron sistemi;

- Kanë rezultuar probleme me funksionalitetet e filtrave në sistem në lidhje me kërkimin mbi çështje të ndryshme, pasi filtri sipas një numri të caktuar jep të gjitha çështjet që përmbajnë një nga numrat e vendosur në filtër, duke mos ofruar rezultatin e kërkuar;

- GjShPJPSH nuk ka regjistruar asnjë avokat dhe ekspertë sipas zhvillimeve të bëra në sistemin ICMIS si dhe manualet e përdorimit me qëllim njoftimin elektronik të tyre nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga palët, avokatët dhe ekspertët.

Problematikat mbi funksionalitetet e sistemit sjellin pamundësi për të punuar nëpërmjet sistemit për shkak të mangësive të konstatuara, të cilat pengojnë veprimet operacionale të përdoruesve.

- Nga auditimi konstatohet se, sesionet 'Pagesa', 'Pagesat e mëparshme', 'Listë Kontrolli', nuk janë funksionale dhe nuk kryejnë asnjë funksion nëpërmjet sistemit, gjithashtu sesioni 'Printo' është një opsion i cili nuk përdoret nga punonjësi i cili gjeneron statistikën. Nga komunikimet dhe pyetësorët me personat të cilët merren me gjenerimin e statistikave kritere të rëndësishme në raportimet që ato bëjnë janë 'Tipi i Dispozitivit', 'Data e Shortimit', si dhe 'Baza Ligjore e Padisë' për të cilat të gjitha rastet e gjeneruar kontrollohen dhe identifikohen manualisht me qëllim gjenerimin e raportimeve informative.

Nga auditimi mbi çështjet që janë regjistruar në sistem dhe në vijimësi rezultojnë se nuk janë në kompetencë të GjShPJPSH, konstatohet se për këto çështje nuk ka një opsion identifikues në sistem me qëllim mbylljen e tyre si moskompetencë e gjykatës, por për atë çështje të regjistruar si rekord në sistem bëhet një vendim dhe dispozitiv fiktiv me qëllim mbylljen e çështjes me të gjitha elementët e mbylljes. Më pas këto çështje kalojnë në një tjetër gjykatë kompetente nga ku marrin një numër të ri çështjeje pasi regjistrohen në sistem, duke sjellë dublim të këtyre çështjeve për aq sa janë regjistruar në sistem nga ana e GjShPJPSH me çështjet që gjykata kompetente do të hedhë në sistemin e saj lokal, duke sjellë gjenerim statistikor të përgjithshëm të pasaktë për gjykatat nëpërmjet sistemit.

Gjithashtu nga analizimi i të dhënave, rezultoi se sistemi ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të pasakta. Konstatohet se vërtetimet për personat që kanë proces gjyqësor të hapur në gjykatë (nuk kanë marrë një vendim apo dispozitiv përfundimtar), për persona fizik dhe juridik vazhdojnë të realizohen manualisht në mënyrë opsionale në word nga kryesekretaret e institucionit, pasi ekziston risku i të dhënave të hedhura gabimisht në sistem duke qenë se sistemi nuk ndërvepron me sisteme të tjera si DPGJC me qëllim gjenerimin e të dhënave të sakta.

- Nga auditimi konstatohet se për çështjet që janë regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) atributi 'Nr. i Aktit' i cili gjenerohet automatikisht nga sistemi dhe që duhet ti shënohet manualisht dosjes së çështjes së printuar nuk korrespondon me numrin që i vendoset dosjes fizike së çështjes. Hedhja e këtij numri bëhet manualisht duke shënuar për çdo dosje fizike numrin progresiv sipas numrit të çështjeve që trajton secili gjyqtarë, situatë kjo e cila sjellë moskoordinim të dosjeve fizike me dosjet elektronike në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe mos gjurmueshmëri për secilën çështje, mangësi kjo që vjen nga mungesa e rregullores së brendshme.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të brendshme në funksionim të përmbushjes së veprimtarisë institucionale.

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie institucionale në të cilën të integrojë edhe komponentët e teknologjisë së informacionit, si një faktor mbështetës për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të marrë masa për hartimin e rregulloreve dhe procedurave mbi Teknologjinë e Informacionit, vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme të funksionimit të saj.

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për adresimin e parregullsive në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si administrator i sistemit, në lidhje me përmirësimin, rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi, si dhe të gjitha rastet që do të konsiderohen si anomali të sistemit me qëllim saktësimin, plotësimin dhe sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit nëpërmjet sistemit.

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të adresojë tek Këshilli i Lartë Gjyqësor, parregullsitë për krijimin e mekanizmave të nevojshëm, shtimin e kriterëve të rëndësishme në raportimet që GjShPJPS kryen, implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit në sistem, si dhe automatizimin e plotë të shërbimit nëpërmjet sistemit, me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit dhe gjenerimin e statistikave të sakta.

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për rakordimin e numrit të aktit, me numrin e çështjes për çdo dosje të cilat gjenerohet nëpërmjet sistemit, për të rritur gjurmueshmërinë dhe saktësinë e tyre në procesin e informatizuar.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, Manualin e Auditimit IT, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, vlerësojmë se mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në zhvillimin e pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera dhe të dhënave që gjenerohen nëpërmjet sistemit ICMIS (Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore).

Sistemi ICMIS i cili ka rëndësi të veçantë për sistemin e drejtësisë edhe pse ka pësuar ndryshime dhe zhvillime teknologjike ndër vite, si në shtim funksionaliteti, role dhe zhvillime të reja, janë shfaqur një sërë problematikash të cilat vështirësojnë ndjeshëm punën e përdoruesve me sistemin, saktësinë dhe përmbajtjen e informacionit që regjistrohet, aksesueshmërinë e tyre e si rrjedhojë përdorueshmërinë e informacionit nga strukturat e tjera ku Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër raporton. Gjithashtu, infrastruktura qendrore e teknologjisë së informacionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk është në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 272/1, me datë 20.03.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.03.2025 deri më datë 16.05.2025, në subjektin “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.S, përgjegjës grupi;
2. A.K, audituese.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në GjShPJPSH, nga data 20.03.2025 deri më datë 16.05.2025. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 272/1 Prot, datë 20.03.2025:

1. *Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*
2. *Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit*

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në ushtrimin e veprimtarisë së saj ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve dhe akteve nënligjore, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë. Menaxhimi me efektivitet dhe efikasitet i fondeve buxhetore, të miratuara për pushtetin gjyqësor nga njëra anë me ligjin e buxhetit, e nga ana tjetër fondet e përfituara nga donatorë të ndryshëm, vendas apo të huaj, për të mbështetur pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi GjShPJPSH mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që janë implementuar në sistemet informatike.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 272/1 Prot., datë 20.03.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon institucioni nën auditim si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 14, datë 19.12.2022 “Për Miratimin e Standardeve të Ndërtimit dhe Administrimit të Dhomës së Serverave Për Sistemin e Drejtësisë” të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë;
- Rregulloret përkatëse të GjShPJPSH, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, si dhe ISSAI 5300 Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 100 Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, etj.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumentacioneve për sistemet informatike që institucioni disponon;
- Shqyrtimi i informacioneve dhe raporteve të institucionit në auditim;
- Intervista të zhvilluara me personelin kyç të GjShPJPSH;
- Verifikimi dhe analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjykon çështje që hyjnë në kompetencën territoriale të rrethit të Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë, të cilat varësisht objektit të gjykimit ndahen në çështje civile dhe penale. Veprimtaria e gjykatës bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Misioni i gjykatës është gjykimi i mosmarrëveshjeve penale, civile, familjare duke u bazuar në dispozitat normative juridike dhe faktike, të mishëruara në vendimet gjyqësore.

Objektivat e GjShPJPSH janë:

- Organizimin dhe konsolidimin e Gjykatës, si njësi efektive në realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

- Menaxhimi me efektivitet, staf i orientuar drejt plotësimit të kërkesave të qytetarëve.

- Shërbime publike me cilësi të lartë.

- Përmirësimin e kushteve të gjyqësorit, nëpërmjet një menaxhimi sa më efektiv të fondeve të akorduara atij.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Në zbatim të pikës 1 “Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK” të Programit të Auditimit nr. 272/1, datë 20.03.2025 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;

- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;

- Lista e punonjësve të IT sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë;

- Përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi;

- Vendim nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”;

- VKM nr. 971, datë 02.12.2020 “Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë”;

- VKM nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”;

- Vendim, nr. 6 datë 03.2025 miratuar me nr. 581 prot., datë 19.03.2025;

- Vendim nr. 4, datë 31.03.2023 mbi strukturën organizative të GjShPJPSH;

- Regjistër risku si dhe planet e menaxhimit të tij për periudhën e audituar;

- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;

- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës;

- Etj.

➤ Vlerësimi i Burimeve Njerëzore


Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjykon çështje që hyjnë në kompetencën territoriale të rrethit të Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Pukës, të cilat varësisht objektit të gjykimit ndahen në çështje civile dhe penale.

Për kryerjen e funksioneve institucionale Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka një strukturë organizative të miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendim nr. 4, datë 31.03.2023 e cila është e ndërtuar mbi bazën e Sektorëve.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është gjithsej 79 punonjës nga të cilët 15 Gjyqtar, 40 nëpunës civil gjyqësor dhe 24 nëpunës të tjerë gjyqësor. Teknologjia e Informacionit është pjesë përbërëse e sektorit të IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.

Me Vendim nr. 6 datë 03.2025 miratuar me nr. 581 prot., datë 19.03.2025 “Për ndryshimin e vendimit nr. 4, datë 31.03.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, Këshilli ka vendosur shtimin e organikës për këtë gjykatë, ku Sektori i IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median nga 4 (katër) punonjës (1 shef sektori, 1 specialist IT, 1 specialist IT dhe statistikë dhe 1 specialist marrëdhënie me publikun dhe median) është bërë më 5 (pesë) punonjës (1 shef sektori, 2 specialist IT, 1 specialist statistike dhe 1 specialist marrëdhënie me publikun dhe median).

Diagrama nr.1: Organigrama e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në lidhje me sektorin IT



Burimi: GJSHPJPSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për kryerjen e detyrave dhe përkrahjet e punës së punonjësve të GjShPJPSH-ës bazohet në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”.

Me Vendim nr. 5, datë 05.04.2023 është vendosur transferimi i përhershëm i punonjësve të administratës që ushtron funksionet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër) në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër duke filluar detyrën pranë kësaj gjykate më datë 01.05.2023, me detyrat që ka secili prej tyre në pozicionet përkatëse. Për sa më sipër Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median ka vendosur:

Transferimin e përhershëm të 1 (një) punonjësi nga pozicioni “Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit” në pozicionin “Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit”;

Transferimin e përhershëm të 1 (një) punonjësi nga pozicioni “Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit” në pozicionin “Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Specialist i statistikave gjyqësore”;

Transferimin e përhershëm të 1 (një) punonjësi nga pozicioni “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë” në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”.

Tabela nr.1: Struktura e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas pozicioneve që ka secili punonjës aktualisht

| Nr. | Pozicioni | Nr. i punonjësve | | |
|--|---------------|------------------|------|--------------------------------|
| | | Plan | Fakt | Arsimimi |
| Sektori i IT, Statistike dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median | | | | |
| 1 | Shef Sektori | 1 | 1 | Drejtësi |
| 2 | Specialist IT | 1 | 1 | Master Teknologji Informacioni |

| | | | | |
|---------------|--|----------|----------|-------------|
| 3 | Specialist IT dhe statistike | 1 | 1 | Informatikë |
| 4 | Specialist Statistike | 1 | 1 | Juridik |
| 5 | Specialist për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median | 1 | 1 | Drejtësi |
| Totali | | 5 | 5 | |

Burimi: GJSHPJPSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Pozicioni që aktualisht është specialistit i IT dhe statistikave ka qenë specialist IT në gjykatën e Apelit Shkodër i transferuar më pas po si specialist IT në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendim nr. 1, datë 01.02.2023 të Këshilli i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nga auditimi u konstatua se për sektorin e IT, Statistikë dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median në detyrat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 150, datë 29.03.2023 janë të përshkruara detyrat për specialist të teknologjisë së informacionit dhe specialist për statistikat gjyqësore dhe nuk ka detyra të përcaktuara për specialistin e IT dhe statistikave.

Pozicionet e strukturës së datës 31.03.2023 ku ky sektor përfshin specialistin IT dhe statistikë bie në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 150, datë 29.03.2023 në të cilën nuk ka një përshkrim pune për këtë pozicion.

Për sa më sipër nuk ka asnjë dokumentacion në GjShPJPSH që të ketë të përcaktuar dhe përshkruar detyrat për këtë pozicion pune.

Me Vendim nr. 15, datë 21.01.2025 “Mbi miratimin e detajimit të punonjësve shtesë për vitin 2025, për Sistemin Gjyqësor” është shtuar struktura me një specialist statistike për Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për të cilin janë të përcaktuara detyrat në Vendimin nr. 150, datë 29.03.2023.

Nga auditimi u konstatua se, pozicioni i punës i cili kishte emërtimin e pozicionit si specialist IT dhe statistike me Vendimin nr. 54, datë 23.07.2025 “Për saktësimin e Vendimit nr. 6 datë 19.03.2025 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër” është ndryshuar në Specialsit të Teknologjisë së Informacionit funksion të cilin ushtron dhe kryen detyrat në përputhje me Vendimin nr. 150, datë 29.03.2023.

Nga auditimi u konstatua se, në dosjet personale të punonjësve mungojnë përshkrimet e punës të miratuara sipas pozicionit të secilit prej tyre, për kryerjen e detyrave funksionale bazohen vetëm në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”.

Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk disponon një rregullore të brendshme në të cilën të përcaktohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë institucionale si dhe detyrat funksionale të punonjësve duke përfshirë edhe teknologjinë e informacionit.

➤ **Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK**

Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

- *Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka miratuar një strategji institucionale si dhe nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e*

lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale.

Mungesa e një plani strategjik institucional të lidhur edhe me teknologjinë e informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme të cilat mund të mbështesin mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikatat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

- *Nga auditimi u konstatua se*, Teknologjia e Informacionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. GjShPJPSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikatat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

➤ **Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK**

Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuar, monitorimit të rreziqeve të identifikuar më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra rreziku i institucionit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

- *Nga auditimi u konstatua se*, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk disponon regjistër risku për teknologjinë e informacionit, në asnjë formë nuk rezulton të jenë dokumentuar risqe të identifikuar për periudhën e audituar. Kjo në kundërshtim me nenin 11, pika 2: “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë*”, 12 pika 3/d: “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë*” si dhe nenin 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve*”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”, GjShPJPSH duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 272/4 prot., datë 12.08.2025 “*Observacion mbi gjetjet e Projekt Raportit nr. 272/3, datë 15.07.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 1.1 nga ana e Këshillit të Gjykatës u ndërmor Vendimi nr. 54, datë 23.07.2025 “*Për ndryshimin e emërimit të Pozicionit të Punës*

z. B.H nga Specialist i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës” në “Specialist i Teknologjisë së Informacionit”, funksion të cilin ushtron.

Në lidhje me rekomandimin 1.2 nga ana e Këshillit të Gjykatës u ndërmor Vendimi nr. 54, datë 23.07.2025: “Miratimin e detajimit të këtyre pozicioneve të punës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në përputhje me ato të përcaktuara në vendimin 150, datë 29.03.2025, të KLGJ-së për secilin pozicion”.

Në lidhje me rekomandimin 2.1 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e draft-rregullores dhe kalimin e tij për miratim në Këshillin e Gjykatës.

Lidhur me rekomandimin 3.1 dhe 3.2 Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, planet strategjike, rregulloret si dhe standartet, mbikëqyren dhe miratohen nga KLGJ dhe QTI. ...

Në lidhje me rekomandimin 4.1 ... nga ana e KLGJ gjatë muajit korrik janë zhvilluar dy module trajnimesh. Në lidhje me nëpunësit e tjerë përdorues të sistemit që menaxhon të dhënat gjyqësore nga ana e nëpunësve të Teknologjisë së Informacionit pranë kësaj gjykate (IT), ato trajnojnë herë pas here punonjësit në lidhje me ndryshimet e realizuara nga KLGJ, në sistem, apo në rastet kur emërohen punonjës të rinj (përdorues të rinj të sistemit). Ky proces nuk është dokumentuar deri me fillimin e këtij auditimi. Nga ana e sektorit janë marra masa për dokumentimin e trajnimeve apo takimeve të punës që punonjësit IT kanë realizuar me punonjësit e tjerë të gjykatës nën mbikqyrjen e kancelares dhe shefit të sektorit. Në lidhje me këtë pikë gjeni bashkëlidhur korrespondencat sa i përket: 1. Trajnimit të punonjësve të gjykatës datë 30.04.2025 dhe materialin shpërndarë atyre (aktet dhe rregulloret e KLGJ); 2. Trajnimit të IT-ve nga ana e KLGJ në dy modulet e korrikut 23-25 korrik 2025 dhe 29-31 korrik 2025. KLGJ për vitin 2025 ka patur të planifikuar trajnime për IT të gjykatave, ku gjatë muajit korrik janë organizuar dy trajnime tre ditore në Ethical Hacker dhe Introducion to Cybersecurity nga ana e KLGJ-së dhe do vazhdojë me module të tjera në vijim.

Në lidhje me rekomandimin 5.1 konstatimi sa më sipër rezulton të jetë i saktë, pasi GjShPJPSH nuk ka regjistër risku posaçërisht për teknologjinë. Ndërkohë nga ana jonë në pyetësor është përcaktuar se gjykata administron rrjetin e brendshëm të teknologjisë së informacionit, ndërkohë që shërbimet në lidhje me sistemet menaxhohen nga ana e KLGJ-së. Nga ana e GjShPJPSH, do merren masa në përputhje me politikat dhe orientimet e KLGJ-së që të përfshihet në regjistrin e riskut të gjykatës në kuptim të Ligjit për Menaxhimin Financiar, në mënyrë më të detajuar menaxhimi i riskut në sektorin e teknologjisë. Bashkëlidhur gjeni Planet për menaxhimin e Riskut për GjShPJPSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin mbi pikën 1.1 GjShPJPSH ka marrë masat për realizimin e këtij rekomandimi dhe kjo do të reflektohet në raportin përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me observacionin mbi pikën 1.2 sqarojmë se rekomandimi është për plotësimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës për punonjësit dhe jo mbi detajimin e pozicioneve të tyre në strukturën e GjShPJPSH.

Në lidhje me observacionin mbi pikën 2.1 sqarojmë se GjShPJPSH është në fazën e një draft-rregullore, duke qenë se nuk ka ende një rregullore të miratuar grupi i auditimit do të mbaj të njëjtin qëndrim.

Në lidhje me observacionin mbi pikën 3.1 dhe 3.2 sqarojmë se për arsye se kompetencën e miratimit të dokumentacioneve e ka KLGJ këto rekomandime janë lënë në bashkëpunim duke qenë se është domosdoshmëri pasja e tyre në mirëfunksionim të institucionit.

Në lidhje me observacionin mbi pikën 4.1 grupi i auditimit ka shqyrtuar dokumentacionin dhe do reflektoj ndryshimet në raportin përfundimtar të auditimit.

Mbi observimin e bërë në lidhje me regjistrin e riskut pika 5.1 GjShPJPSH është përgjigjur se do të marrë masa për realizimin e tij. Për sa i përket Planit për menaxhimin e Riskut ju bëjmë me dije se ky dokumentacion është shqyrtuar nga grupi i auditimit dhe ka rezultuar të jetë plan veprimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe jo regjistrer risku.

2.2 Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 2 “*Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit*” të Programit të Auditimit nr. 272/1, datë 20.03.2025 janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemet informatike si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre si:

- Përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së informacionit në GjShPJPSH;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi;
- Aktet rregullative që lidhen me sistemet;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administrojnë shërbime të caktuara në sistem;
- Vizita në terren;
- Indikatorë dhe statistika, etj.
- Skema e komunikimit të network-ut;
- Konsultim me faqen e web-it të GjShPJPSH, etj.

Lidhur me sistemet/aplikacionet e teknologjisë së informacionit që GjShPJPSH është përdorues janë si më poshtë;

- 1- Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore – ICMIS, version i webservice, i ndërtuar me .NET instaluar dhe konfiguruar nga KLGJ;
- 2 - Trellix (Endpoint Security) versionin klient i cili konfigurimet dhe politikat e sigurisë i merr serveri qendror në KLGJ;
- 3- Symantec endpoint protection versionin klient i cili konfigurimet dhe politikat e sigurisë i merr serveri qendror;
- 4 - RDAS i cili përdoret për regjistrimin e seancave gjyqësore vetëm me audio dhe me video.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”, neni 92, pika 2 përcaktohet se:

Në përputhje me politikat e përgjithshme në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me qendrën e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë është përgjegjës për:

- a) zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata;
- b) menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në gjykata;
- c) përcaktimin e sistemit të zbatueshëm të sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve dhe kujdeset që sistemi të përdoret në çdo gjykatë;
- ç) përcaktimin e rregullave për funksionimin, dhe sigurinë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi;
- d) mirëmbajtjen e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve, në përputhje me rregullat e parashikuara në shkronjën “b” të këtij neni;
- dh) ofrimin e asistencës teknike për gjykatat në përdorimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve;
- e) përmirësimin periodik të sistemit, për të siguruar zbatimin e kërkesave funksionale të gjykatave, të vetë Këshillit dhe të organeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë, si dhe për të reflektuar ndryshimet në ligjet procedurale;

- ë) sigurimin e saktësisë dhe sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- f) garantimin që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të të dhënave gjeneron informacione statistikore, të cilat janë të nevojshme për punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të organeve të tjera dhe që përputhen me standardet europiane për treguesit e punës së gjyqësorit, të tilla si norma e evadimit të çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar, kohëzgjatja mesatare e çështjeve dhe kohëzgjatja e çështjeve në proces në raport me kohëzgjatjen mesatare etj;
- g) përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, njësimin e futjes së të dhënave dhe për saktësinë e të dhënave.

Që nga viti 2005, në gjykatat shqiptare funksionojnë dy sisteme të ndryshme elektronike të menaxhimit të çështjeve ARKIT dhe ICMIS. Rezulton se nga 38 gjykata në territorin shqiptar, 36 prej tyre përdorin sistemin ICMIS, ndërsa vetëm dy gjykata, përkatësisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Posaçme e Shkalles së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përdorin sistemin ARKIT.

Për periudhën 2005 - 2010 GjShPJPSH ka pasur në përdorim si sistem të menaxhimit të çështjeve sistemin ARKIT me përdorues të kufizuar, në të cilin nuk janë hedhur më të dhëna por vetëm përdoret për të marrë informacion për çështjet/vendimet dhe çështjet e gjykuara për periudhën 2005-2010.

➤ Sistemi RDAS (Regjistrimi Dixhital Audio) është në përdorim nga GjShPJPSH që nga viti 2015. Ky sistem është përdorur për regjistrimin e seancave gjyqësore vetëm me audio deri më datën 23.11.2024, më pas nëpërmjet këtij sistemi ka filluar regjistrimi i seancave gjyqësore edhe me video.

Pjesë e këtij sistemi janë:

- FTR Reporter, Recorder Manager & Player version i instalueshëm paketë e plotë licensuar ofruar nga KLGJ;

- FTR LogNotes, version i instalueshëm i licensuar ofruar nga KLGJ;

Recorder Manager është i instaluar në PC të sallave dhe realizon regjistrimin audio-video të seancave gjyqësore, si dhe është i instaluar dhe në PC e sekretareve gjyqësore me qëllim ruajtjen në CD të seancave i cili i bashkëlidhet dosjes gjyqësore së bashku me shënime të përkatëse në format shkresor;

FTR Player është i instaluar në PC e sekretareve gjyqësore dhe shërben për dëgjimin e seancave gjyqësore me qëllim saktësimin e procesverbalin e shënimeve të seancës nga sekretarja gjyqësore;

FTR LogNotes për gjyqtarët shërben për të dëgjuar sekuenca specifike të seancës sipas çështjeve. Ky sistem është version i instalueshëm paketë e plotë licensuar dhe ofruar nga KLGJ, dhe gjykata është përdoruese e tij në seancat gjyqësore.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore – ICMIS

Grupi të auditimit sipas përgjigjes së informacionit nr. 1, datë 07.03.2025, i është vendosur në dispozicion Udhëzuesi për sistemin ICMIS, miratuar me urdhër nr. 382/1, datë 03.02.2016 “Për miratimin e udhëzuesit për sistemin ICMIS “Funksionalitetet dhe të drejtat e përdoruesve në sistemin ICMIS”” nga ministri i Drejtësisë, në të cilin shpjegohen funksionalitetet dhe të drejtat e përdoruesve në sistemin ICMIS.

Sistemi ICMIS është i dizenuar për menaxhimin e të dhënave të dosjeve civile dhe penale.

Rolet dhe funksionalitetet që ofron sistemi ICMIS për mbarëvajtjen e procesimit të dosjes janë të përshkruara si më poshtë vijon:

Administratori i Sistemit (IT)

Administratori i sistemit ka si funksionalitet konfigurimin e gjykatës dhe të përdoruesve të sistemit. Konfigurimin e përdoruesve të cilët do të kenë një rol specifik në gjykatë: sekretaren regjistruese, gjyqtarin, kryetarin e gjykatës, sekretaren e seancës etj. Gjithashtu bënë

konfigurimet përkatëse për përcaktimin e këtyre përdoruesve në GMC¹ dhe Trupat Gjykes. Funkcionalitet tjetër i administratorit është konfigurimi i gjykatës, si: përcaktimin e orareve të punës të gjykatës, sallat e gjyqit, ditët e pushimit, si dhe përcaktimin për procesimin e dosjeve nëse vendimet do të marrin numër vendimi apo jo. Konkretisht si më poshtë:

1. Konfigurimet e Gjykatës:

- Mjetet e Ankimit, ku vendoset numri i mjetit, Arsytet e fillimit, statusin dhe numrin e palëve;
- Listës se kontrolleve, për kontrollin e Dosjes;
- Sallat e Gjyqit, shtohet Salla e gjyqit, ku më pas vendoset kodi i sallës, ndërtesën, katin, përshkrimin dhe statusin;
- Filtrimi i çështjeve nga publiku, ku zgjidhet lloji i filtrit, më pas përzgjedh llojin e çështjes që dëshiron të fshihet nga publiku;
- Konfigurimi i gjykatës, ku mund të ndryshojë orarin e punës së gjykatës, planifikimet nga ana e gjyqtarit apo sekretares etj.;
- Lejet e Punonjësve, ku përcakton lejet e punonjësve sipas punonjësit, përshkrimi, datën e fillimit dhe të mbarimit të lejes dhe në fund gjendjen;
- Ditë pushimi, ku vendos datën dhe përshkrimin përkatës.

2. Konfigurimet e Përdoruesve

- Shtimi i përdoruesit në sistem, ku për punonjës të ruhen të dhënat: kodi i punonjësit, emri, funksionin në gjykatë dhe datën e ardhjes në gjykatë;
- Konfigurimi i GMC (Grupit të Menaxhimit të Çështjes), për përdoruesit të sistemit që bëjnë pjesë në GMC vendoset kodi i GMC-se, data e efektivitetit dhe në fund përzgjidhet gjyqtari dhe sekretarja përkatëse;
- Konfigurimi i Trupave Gjykes, ku plotësohet kodi i trupit gjykes, data e efektivitetit dhe në fund përzgjidhen gjyqtarët e trupit gjykes nga lista e gjyqtarëve.

3. Konfigurimet e ndryshme për dosjen

- Numërtimi i Vendimeve, ku Administratori i Sistemit gjithashtu mund të bëjë numërtimin e vendimeve, duke përcaktuar nëse ai vendim do numërohet apo jo, duke përzgjedhur tipin e çështjes dhe objektin e akuzës.

Sekretarja Regjistruese

Funksionaliteti kryesor i Sekretares Regjistruese është regjistrimi i dosjes në sistemin ICMIS me të gjithë informacionin si: informacioni bazë i dosjes, informacioni për palët, akuzat, dokumentet e ndryshme, provat etj. Mbase ka plotësuar të gjithë informacionin e dosjes, përfundon regjistrimin e dosjes në sistem, ku mbas këtij veprimi sekretarja nuk ka më mundësi modifikimi mbi dosjen. Veprimet e mëtejshme mbi dosjen i kalojnë në përgjegjësi roleve të tjerë. Pasi mbyllet procesi i regjistrimit të dosjes, ajo kalon në rradhën e punës tek kryetari i gjykatës për shortimin e dosjes.

Funksionalitet bazë të rolit 'Sekretarja Regjistruese' janë:

Regjistrimi i dosjes:

- o Dosje Penale
- o Dosje Civile

Kryetari i gjykatës

Funksionaliteti kryesor i Kryetarit të Gjykatës është shortimi i çështjeve. Shortimi i çështjeve bëhet në mënyrë të tillë që të gjitha çështjet të kalojnë për gjykim tek gjyqtarët sipas logjikës së shortit. Gjithashtu, ai kryen menaxhimin e gjykatës tek burimet e çështjes, për rishortimet e dosjeve, caktimet manuale, ndryshimin e panelit të trupit gjykes në varësi të dosjes. Në rastin kur një gjyqtar largohet nga gjykata, kryetari i gjykatës bën shortimin e këtyre çështjeve tek

¹ Grupi i Menaxhimit të Çështjeve

gjqqtarët e tjerë nëpërmjet logjikës së shortit ose caktimin e tyre tek një gjyqtar specifik.

Funksionalitet bazë të rolit 'Kryetari i gjykatës' janë:

- Hedhja e shortit;
- Menaxhimi i Gjykatës;
- Ekspertët e Gjykatës;
- Përparësitë e çështjes;
- Cakto gjyqtarin;
- Ndryshim Gjyqtari (Short i ri);
- Ndrysho GMC;
- Ndrysho Panelin;
- Ndryshimi i Gjyqtarit (Disa)

Shortimi elektronik i çështjeve kryhet nga Kryetari/Zv. Kryetari i gjykatës, e cila sigurohet nëpërmjet një lidhje të pa ndërprerë VPN në serverin e gjykatës si dhe ndarja e çështjes me short elektronik dhe kodi unik i organizimit të shortit është sipas vendimit nr. 554, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku specifikohet përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë.

Gjyqtari

Funksionalitet kryesor i një gjyqtari është hedhja e vendimeve në sistem duke përfshirë vendimet e ndërmjetme, përfundimtare etj. Në momentin që merret një vendim përfundimtar për një dosje, gjyqtari bën të mundur regjistrimin e vendimit në sistemin ICMIS. Mbas këtij veprimi hapi tjetër është mbyllja e dosjes në sistem. Gjatë procesit gjyqësor kalon çështjen tek rolet e tjera që kanë lidhje me çështjen për veprime të ndryshme sipas rregullores.

Kalimet kryesore janë midis gjyqtarit dhe sekretares së seancës e cila ka përgjegjësi të ndryshme mbi çështjen.

Funksionalitet bazë të këtij roli janë:

- Planifikimi i seancës, ku mund të shtojë një planifikim të ri dhe përcakton datën e mbajtjes së seancës, numri i çështjes, orari dhe salla, ku shfaqet dhe pjesëmarrësit në seancën si gjyqtarë etj;
- Studimi i Çështjes, ku përcakton nëse çështja penale do të gjykohet me trup gjykues dhe përcakton arsyen. Për çështje civile mund të vendosë nëse vlera e padisë është më e madhe se 10 milion lekë, deklarim i një personi si i humbur ose i vdekur, kufizimi i kapacitetit Juridik të Personit etj;
- Shpallja dhe regjistrimi i vendimit, pasi çështja është hapur për editim nga ana e gjyqtarit mund të shtojë një vendim mbi çështjen duke vendosur arsyet përkatëse, gjendjen e vendimit, llojin e gjykimit etj.

Sekretarja e Seancës

Funksionaliteti kryesor i Sekretares të Seancës është regjistrimi në sistem i procesverbaleve dhe dispozitiveve të dosjes për seancat e zhvilluara për dosjen. Sekretarja është e konfiguruar në një GMC me një gjyqtar, ku në varësi të procesit të punës të gjykatës një sekretare mund të jetë e konfiguruar në më shumë se një GMC.

Funksionalitet bazë të këtij roli janë:

- Planifikimi i seancës, ku për një planifikim të ri përcaktohet data e mbajtjes së seancës, numri i çështjes, orari dhe salla. Gjithashtu shfaqen pjesëmarrësit në seancë si gjyqtarët etj;
- Regjistrimi i procesverbalit, ku vendoset statusi i gjykimit, gjyqtarët, prokurorët, palët, adresat e palëve etj. Gjithashtu në këtë hap përcaktohet nëse seanca do të jetë me dyer të hapura apo me dyer të mbyllura;
- Regjistrimi i dispozitivit, duke plotësuar fushat mbi dispozitivin si lloji i dispozitivit, përshkrimi përkatës, ora e dhënies së dispozitivit etj.

Kancelari

Funksionaliteti kryesor i Kancelarit është shtyrja e afatit të përfundimit të regjistrimit nga sekretarja regjistruese. Në rastin kur sekretarja regjistruese nuk përfundon regjistrimin e dosjes brenda afatit të përcaktuar kjo dosje kalon në radhën e punës të kancelarit. Ky rol menaxhon këto çështje duke shtyrë afatin e përfundimit të regjistrimit dhe më pas dosja ri kalon përsëri në llogari të Sekretares Regjistruese.

Funksionalitet tjetër i kancelarit është funksionaliteti i fshirjes së çështjeve. Kancelari mund të fshijë çështje të ndryshme që janë hapur gabim ose për ndonjë arsye tjetër.

Gjithashtu procesi i mbartjes së çështjeve në fillim të vitit ose procesi i anulimit të mbartjes për çështje të caktuara.

Kryesekretarja

Fillimisht ky rol është krijuar që të ketë vetëm të drejta leximi në sistem, më pas me përditësimet e sistemit janë shtuar funksionalitete të tjera të rolit Kryesekretare, si marrja e çështjes në dorëzim, anulimi i çështjes si dhe mbyllja e saj.

Arkivisti

Arkivisti është roli i fundit të cilit i kalon çështja në ngarkim pasi ka përfunduar procesimi i dosjes. Nga ana e sistemit ICMIS Arkivisti nuk mund të kryejë veprime modifikuese mbi dosjet, vetëm mund ti kontrollojë ato. Më poshtë tregohen funksionaliteti bazë i këtij roli.

Figura e mëposhtme tregon pamjen e ndërfaqes së përdoruesit, për të hyrë në sistemin ICMIS me kredencialet e tij:



Përdoruesi:

Fjalëkalimi:

→ Hyrje ↺ Rifillo

Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore – ICMIS është përdorur nga GjShPJPSH që prej vitit 2010. Ky sistem ka pësuar ndryshime dhe zhvillime teknologjike ndër vite si në shtim funksionaliteti, role të reja dhe zhvillime të reja në sistem.

Për këtë sistem GjShPJPSH ka serverin e vetë të instaluar në nivel lokal si dhe Active Directory ku menaxhohet baza e të dhënave për sistemin ICMIS.

Të dhënat që sekretarja e gjykatës hedh në sistemin ICMIS për një çështje të caktuar janë:

- Nr. i Çështjes;
- Titulli i Çështjes;
- Regjistri;
- Nr. i Aktit;
- Numër Akti Regjistër;
- Data e Dorëzimit;
- Dorëzuesi;
- Lloji i Procedurës;
- Rrethana Rënduese
- Vlera e Padisë (Lekë);
- Lloji i Çështjes;
- Objekti i Padisë/Kërkesës;
- Padi me palë gazetares/përfaqësues mediash;

- Baza Ligjore e Padisë/Kërkesës;
- Pjesë Përshkruese;
- Objekti i K/Padisë;
- Baza Ligjore e Kundër Padisë;
- Çështje të Ngjashme;
- Shënime;
- Kodi i Anonimizimit;

Gjithashtu për një Çështje të hedhur në sistem shfaqen të dhëna mbi:

- Info. Mbi Çështjen;
- Palët;
- Vendime të mëparshme;
- Dokumente;
- Provat;
- Pagesat;
- Kontrolllet;
- GMÇ dhe Trupi Gjykues;
- Shënime
- Studimi i Çështjes;
- Gjyq;
- Vendimi;
- Mbyllja e Çështjes;
- Axhendat;
- RIV;
- Historiku.

Për çdo çështje të regjistruar në sistem gjenerohet automatikisht 'Nr. i Aktit', i cili është numri i cili i bashkëngjitet fizikisht dosjes së çështjes. Brenda një regjistri numri i aktit për çdo çështje të re inkrementohet. Në rastin kur nis viti i ri dhe nuk ka asnjë çështje të regjistruar numri i aktit për regjistrin përkatës fillon nga 1.

Nga auditimi konstatohet se numri i akti i cili i bashkëngjitet fizikisht dosjes së çështjes nuk korrespondon me Nr. e Aktit që gjeneron sistemi, pasi hedhja manuale e këtij numri bëhet fizikisht duke shënuar numrin progresiv për gjyqtarët sipas numrit të çështjeve që i takon secilit.

Aktualisht administratorët e sistemit ICMIS janë specialistët e Teknologjisë së Informacionit sipas organikës së gjykatës z. A.R dhe z. B.H. Konstatohet se të dy punonjësit e sipërcituar përdorin të njëjtin administrator të sistemit me kredencialet 'ccmisAdmin', situatë e cila sjell risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

Nga auditimi konstatohet se detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse për administratorët e sistemeve për periudhën objekt auditimi nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga Kryetari i GjShPJPSH.

Nga auditimi konstatohet se, GjShPJPSH nuk disponon ndonjë dokument Workflow ose diagrama të rrjedhës së informacionit.


Nga auditimi konstatohet se, GjShPJPSH nuk ka hartuar/miratur rregullore për përdorimin e sistemit ICMIS, me qëllim adresimin e qartë të proceseve të punës në një sistem të informatizuar për gjykatën Shkodër. Mungesa e rregulloreve krijon mundësinë për mos përdorimin e sistemeve, e si rezultat dhe mos adresimin e përgjegjësive për mungesën e efektivitetit të çdo hapi të informatizuar;

Gjithashtu konstatohet se, GjShPJPSH nuk disponon një politikë apo rregullore të dokumentuar dhe miratur për administrimin/menaxhimin e përdoruesve për sistemin ICMIS, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve etj.

Nga auditimi i funksionaliteteve të roleve në sistemin ICMIS konstatohet se:

- Nuk ekziston një përdorues/rol në sistem me qëllim gjenerimin e statistikave përkatëse nga sistemi që gjykata raporton në KLGJ apo institucione të tjera. Konstatohet se sektori i statistikave përdor user-in e sekretares me qëllim gjenerimin e statistikave nga sistemi ose statistikën për gjykatën i realizon manualisht në raste kur ka diferenca ose mos koordinim me sistemin;
- Aktualisht roli 'Arkivit' nuk përdoret nga asnjë punonjës i gjykatës;
- Fushat të cilat nuk janë të detyrueshme për tu plotësuar pothuajse në shumicën e rasteve janë lënë bosh, si për çështjet që regjistrohen ashtu dhe për të dhënat e secilit përdorues të sistemit duke lënë hapësirë për mos përdorimin e sistemit me të gjitha funksionalitetet e krijuara në të;
- Data e largimit të punonjësve të cilët janë larguar nga gjykata është lënë e paplotësuar për të gjithë punonjësit e larguar, për shkak se sistemi nuk identifikon më çështjet e trajtuar nga ai punonjës;
- Tek opsioni i Akuzave, ka akuza të cila sistemi nuk i ka të regjistruara me qëllim selektimin e tyre, e për pasojë shtohen nga regjistruesja manualisht me komentin përkatës;
- Tek sesioni 'Kategoria e Çështjes' nuk është shtuar opsioni 'I mitur në konflikt me Ligjin' në sistem, ky opsion shtohet më pas manualisht tek sesioni 'Palët';
- Ekzistojnë opsione të cilat nuk kryejnë asnjë funksion në sistem si prsh., 'Numër Akti Regjistër', ose Opsione në modulet kryesore si:
 - o Moduli 'Administrimi' ka sesione të cilat nuk përdoren si: 'Mesazhe Specifike', 'Ditë Pushimi', 'Lejet e Punonjësve', 'Eksport', 'Kërkim në Serverin Qendror', 'Transfero në Serverin Qendror' dhe 'Anullo Mbartje';
 - o Moduli 'Përcakto' ka sesione të cilat nuk përdoren si: 'Lista e Kontrollit', 'Mesazhe' dhe 'Numërtimi i Vendimeve'.

Konstatohet se asnjë nga çështjet nuk arkivohen dhe nuk shfaqet asnjë informacion për statusin e çështjeve 'të arkivuara'. Gjithashtu moduli 'Arkiva e çështjeve' nuk funksionon si dhe shfaq informacionin si më poshtë:



Numri i përdoruesve të GjShPJPSH sipas roleve në sistemin ICMIS janë si më poshtë:

| Nr. | Rolet dhe përgjegjësitë | Nr. i përdoruesve aktiv |
|-----|-------------------------|-------------------------|
| 1. | Gjyqtare | 10 |
| 2. | Kancelare | 1 |
| 3. | Sekretare gjyqësore | 20 |
| 4. | Specialist sektori TIK | 4 |
| 5. | Arkiva | 2 |
| | Totali | 37 |

Nga auditimi mbi përdoruesit e krijuar në sistem konstatohet se numri total i tyre është 127 aktiv, nga të cilët 37 janë aktiv dhe përdorues, 31 usera janë hapur rishtas për punonjësit e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe 59 janë usera aktiv të cilët janë të larguar, ose gjyqtarë të deleguar të cilët janë lënë aktiv në sistem.

Modulet kryesore të sistemit ICMIS janë:

- Regjistrimi;
- Proçedimi i Çështjes;
- Arkiva;
- Menaxhimi i Gjykatës;
- Administrimi;
- Përcaktimi.

Nga auditimi konstatohet se çdo përdorues në sistem ka akses në të gjithë modulet e sistemit konkretisht dhe tek moduli i Administrimit dhe Përcaktimit ku janë panele për administratorin e sistemi, si dhe jo sipas rolit të përcaktuar që ai përdorues ka, kjo situatë sjell risk në akses të të dhënave dhe kryerjen e veprimeve në sistem nga përdorues të pa autorizuar.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë së fjalëkalimeve të përdoruesve të sistemit ICMIS, si dhe nuk janë zbatuar kritere që forcojnë fjalëkalimet, si përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, sipas praktikave dhe standardeve më të mira. Gjithashtu fjalëkalimet e secilit përdorues të sistemit ICMIS ndryshohen vetëm nga administratorët e sistemit, atëherë në rastet kur kërkohet nga përdoruesi, pasi ata nuk kanë mundësi për ndryshimin e fjalëkalimit.

- Në sistemin ICMIS është opsioni që mund të printohen vërtetimet për personat që kanë proces gjyqësor të hapur në gjykatë (nuk kanë marrë vendim apo dispozitiv), për persona fizik dhe juridik. Sipas manualit të përdorimit të sistemit vërtetimet mund të printohen për të gjitha çështjet e regjistruara, të proceduara por që nuk kanë marrë datë vendimi. Për të printuar një vërtetim, të drejtën e ka kancelari i gjykatës si dhe Kryesekretaria. Vërtetimi gjenerohet si një raport në format word e cila kërkon editim, pasi Gjykata të ndryshme kanë formate të ndryshme.

Nga auditimi konstatohet se në GjShPJPSH aksesin për printimet e vërtetimeve e ka kryesekretaria dhe këto vërtetime vazhdojnë të realizohen manualisht në mënyrë opsionale në word nga kryesekretaret e institucionit pasi ekziston risku i të dhënave të hedhura gabimisht në sistem duke qenë se sistemi nuk ndërvepron me sisteme të tjera si DPGJC me qëllim gjenerimin e të dhënave të sakta.

Gjithashtu konstatohet se vendimet të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi nuk janë sipas formateve të vendimit, duke kërkuar kryerjen e veprimeve manualisht me qëllim minimizimin e gabimeve sipas formatit që gjeneron sistemi.

Nga zhvillimet e bëra në sistemit ICMIS si dhe manualet e përdorimit të tij është shtuar funksionaliteti i shtimit të listës së avokatëve dhe ekspertëve si dhe njoftimin elektronik të palëve nëpërmjet adresës e-mail të deklaruar nga palët, avokatët dhe ekspertët, ku konstatohet se për GjShPJPSH nuk është regjistruar asnjë avokat.

Në lidhje me të dhënat statistikore që gjeneron GjShPJPSH:

Nga komunikimet me personat përgjegjës shpjegohet se të dhënat statistikore të kërkuara nga KLGJ- ja nxirren nga sistemi dhe përpunohen nga Sektorit të IT, Statistikës dhe Marrëdhënien me Publikun dhe Median. Ndërsa të dhëna referuar format raporteve mbi juridiksionin (format raport i kërkuar nga KLGJ-ja në fund të vitit) pjesërisht: Raportimet tremujore të Ministrisë së Drejtësisë etj., nxirren përmes numërimit në regjistrat manual për shkak të dhënave që kërkohen në rubrikat e tabelave të kërkuara pasi janë specifike (çështjeve gjyqësore nen pas neni).

Kriteret e kërkimit 'Informacioni mbi Çështjet' në sistem janë:

1. Nr. i Çështjes;
2. Regjistri;
3. Nr. Akti;

4. Data e Dorëzimit;
5. Palët;
6. Dorëzuesi;
7. Statusi i Çështjes;
8. Lloji i Procedurës
9. Gjyqtar;
10. Nr. i Vendimit;
11. Data e Vendimit;
12. Printo.

Gjithashtu për një çështje të caktuar shfaqen mundësitë e kërkimit në lidhje me:

- Info. Mbi Çështjen;
- Të dhënat për palët;
- Vendime të mëparshme;
- Dokumente;
- Provat;
- Pages;
- Pagesat e mëparshme;
- Listë Kontrolli;
- GMC;
- ProcesVerbali;
- Dispozitivi;
- Vendimi;
- Mbyllja e Çështjes;
- RIV;
- Planifikimi;
- Shënime;
- Raport Përfundimtar;
- Kalim Çështje.

Nga auditimi konstatohet se, Sesionet ‘Pagesa’, ‘Pagesat e mëparshme’, ‘Listë Kontrolli’ nuk janë funksionale dhe nuk kryejnë asnjë funksion nëpërmjet sistemit. Gjithashtu sesioni ‘Printo’ nuk përdoret nga punonjësi i cili gjeneron statistikën. Nga komunikimet dhe pyetësorët me personat të cilët merren me gjenerimin e statistikave kritere të rëndësishme në raportimet që ato bëjnë janë ‘Tipi i Dispozitivit’, ‘Data e Shortimit’, si dhe ‘Baza Ligjore e Padisë’ për të cilat të gjitha rastet e gjeneruar kontrollohen dhe identifikohen manualisht me qëllim gjenerimin e raportimeve informative.

Kanë rezultuar probleme me funksionalitetet e filtrave në sistem në lidhje me kërkimin mbi çështje të ndryshme, pasi filtri sipas një numri të caktuar jep të gjitha çështjet që përmbajnë një nga numrat e vendosur në filtër, duke mos ofruar rezultatin e kërkuar.

Nga auditimi mbi çështjet që janë regjistruar në sistem të cilat rezultojnë se nuk janë kompetencë e GjShPJPSH, konstatohet se për këto çështje nuk ka një opsion identifikues në sistem me qëllim mbylljen e tyre, por për atë çështje të regjistruar si rekord në sistem bëhet një vendim dhe dispozitiv fiktiv me qëllim mbylljen e çështjes. Më pas çështjet kalojnë në një tjetër gjykatë kompetente nga ku marrin një numër të ri çështjeje, duke sjellë dublim të çështjes me një gjykatë tjetër si dhe mos identifikim të saj e cila nuk është e trajtuar nga GjShPJPSH, si dhe gjenerimin statistikor të përgjithshëm të pasaktë për gjykatat.

Nga auditimi u konstatua se sistemi ICMIS nuk përmban politika apo kontrole që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e input-outputit. Nga analizimi i të dhënave, rezultoi se sistemi ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të pasakta.

➤ **Manualet e sistemit ICMIS**

Manualet shërbejnë si udhëzues për të gjithë përdoruesit që kanë të drejta të aksesojnë sistemin ICMIS dha ata përdorues që e përdorin dhe e popullojnë këtë sistem.

Grupi të auditimit i janë vendosur në dispozicion një sërë manualesh të cilat janë të hershme që nga viti 2010 në momentin e përdorimit të sistemit nga GjShPJPSH.

Nga auditimi mbi aktet rregullatore të manualeve të përdorimit të sistemit ICMIS u konstatua se manualet e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të çdo përdoruesi sipas fushës së veprimit që mbulojnë. Këto manuale janë në formë raportimi mbi zhvillimet dhe funksionalitetet që janë kryer mbi sistemin sipas kontratave respektive të mirëmbajtjes së tij. Gjithashtu të gjitha manualet e vendosura në dispozicion grupit të auditimit nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të institucioneve që ka në pronësi apo administron sistemin ICMIS si KLGJ apo Ministria e Drejtësisë e cila e ka pasur në administrim më parë këtë sistem.

➤ **Active Directory**

GjShPJPSH për menaxhimin e përdoruesve, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimit të shërbimeve në përputhje me standardet nuk përdor Active Directory. Çdo pajisje kompjuterike në GjShPJPSH është e lidhur lokalisht, jo në një rrjet të qendëruar.

Nga auditimi mbi ndërtimin logjik të rrjetit të brendshëm dhe aksesimit të tij u konstatua se, në mungesë të konfigurimit me Domain Controller dhe aksesimit në rrjet nëpërmjet Active Directory, siguria në rrjetin e brendshëm është e rrezikuar për sa kohë nuk janë aplikuar për përdoruesit kufizime me impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë e të dhënave dhe informacionit që administron GjShPJPSH. Dokumentet, informacionet që krijohen dhe përpunohen nga çdo pozicion pune nevojitet të ruhet lokalisht, pasi konfigurimet aktuale nuk e bëjnë të mundur ruajtjen e tyre në një server të dedikuar.

Nga auditimi konstatohet se, GjShPJPSH përdor një Active Directory të vënë në dispozicion nga kompania që ka zhvilluar më parë sistemin ICMIS vetëm për përdoruesit e sistemit, të cilët mbasi administratori i sistemit IT realizon hapjen e user-it në Active Directory më pas realizon hapjen e user-it në sistem dhe bënë lidhjen për atë përdorues. Konkretisht:

Konfigurimet e Përdoruesve

- Shtimi i përdoruesit në sistem realizohet:

Për punonjësin ruhen të dhënat: kodi i punonjësit, emri, funksionin në gjykatë dhe datën e ardhjes në gjykatë. Administratori duhet të zgjedhë punonjësin (punonjësin e shtuar në sistem) dhe kodin e përdoruesit (punonjësin e shtuar në Active Directori ku bëhet lidhja me user-in në Active Directori që është shtuar paraprakisht).

Nga auditimi u konstatua se të gjithë konfigurimet e Active Directory janë by default dhe nuk janë të konfiguruar në përputhje me standardet më të mira. Konfigurimi i politikave të sigurisë mbi fjalëkalimet, të drejtat e përdoruesve, të dhënat e sigurisë, etj, janë në gjendjen fillestare të lënë nga sistemi në momentin e implementimit të tij. Këto politika të sigurisë konfigurohen sipas rëndësisë që i kushtohet këtyre elementëve, në mënyrë që rritet niveli i sigurisë së aksesit. Disa nga risqet që vijnë si rezultat i konfigurimeve default i active directory janë:

- Ekziston rreziku i mos menaxhimit të politikave që mund t'i lejojë përdoruesit të marrin shumë të drejta;

- Rreziku që politikave të fjalëkalimit nuk janë në përputhje me kërkesat e entitetit ose praktikave më të mira. Kjo mund ta bëjë më të lehtë për personat e paautorizuar qasjen në rrjet dhe sisteme;

- Fjalëkalimet që nuk skadojnë kurrë mund të rezultojnë në akses të paautorizuar. Ky është veçanërisht një rrezik nëse ka llogari të përbashkëta përdoruesish ose llogari të sistemit me

privilegeje administratori. Kështu, ish-punonjësit mund të abuzojnë me këto të drejta;

- Llogaria e një përdoruesi me një fjalëkalim bosh mund të rezultojë në akses të paautorizuar;
- Nëse kompania ka vetëm një politikë fjalëkalimi, ajo duhet t'i përshtatet të gjitha nevojave, dhe për këtë arsye mund të jetë e dobët, etj.

Figura nr. 1: Politikat e sigurisë së fjalëkalimeve në Active Directory






Figura nr. 2: Politikat e sigurisë në Active Directory



Burimi: Grupi i Auditimit, AD GjShPJPSH

Nga auditimi konstatohet se, Administratori i të dhënave në Active Directory dhe detyrat e tij për periudhën objekt auditimi nuk janë atribuar në asnjë formë nga organet drejtuese të GjShPJPSH, sipas funksioneve dhe të gjitha detyrat e administratorit mbi administrimin e bazës së të dhënave të Active Directory për përdoruesit që aksesojnë sistemin ICMIS.

Nga auditimi i 204 përdoruesit e Active Directory u konstatua se, ekzistojnë përdorues të cilat nuk janë punonjës të GjShPJPSH, gjenden user të cilët janë të pa identifikueshëm me emra si '...', '...', '...', '...', '...', '...', '...', '...', '...', si dhe raste të tjera të punonjësve të cilët janë të larguar

por me statusin aktiv, raste këto të cilat sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistemet dhe në rrjetin e GjShPJPSH, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

Nga auditimi i Active Directory u konstatua se nuk janë bërë përditësimet e fundit, e cila riskon moskthimin në gjendjen të mëparshme të saj.

➤ ***Kontrollet e aksesit, politikat e sigurisë, menaxhimi i privilegjeve, përdorimi i infrastrukturës TIK në krijimin e kushteve optimale në GjShPJPSH***

Në një mjedis shtetëror, kontrolli i aksesit është i rëndësishëm sepse shumë subjekte publike përpunojnë të dhëna sensitive dhe çështjet e privatësisë limitojnë se cilët persona duhet të shohin pjesë të ndryshme të informacionit. Politikat e aksesit japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve të institucionit. Funkzioni i Sigurisë së Informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin e operimit. Politikat e sigurisë së informacionit duhet të mbulojnë të gjithë risqet operacionale dhe të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit.

Nga auditimi konstatohet se në hyrjen kryesore në godinën e GjShPJPSH rezulton një sistem aksesi për hyrje-daljet e punonjësve të GjShPJPSH, ky sistem i ngritur është jashtë përdorimit nga stafi me qëllim monitorimin e lëvizjeve dhe hyrje daljeve, gjë e cila kompromenton nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet fizike të GjShPJPSH, duke mbartur riskun e ndërhyrjes ndaj informacioneve si dhe akses i paautorizuar në ambientet fizike të GjShPJPSH.

➤ ***Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve***

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe komunikimi i brendshëm institucional si dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet TI që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nga punonjësit të mbështetjes i cili ka profil TI, nëpërmjet e-mail-eve, komunikimeve me celular apo shkëmbimeve verbale.

Nga auditimi u konstatua se, GjShPJPSH nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI. Nga intervistat e zhvilluara me personat përgjegjës në GjShPJPSH, konstatohet se nuk disponohet procedurë për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë për kryerjen e ndryshimeve në proceset e punës operacionale të GjShPJPSH.

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh, ku suporti dhe komunikimi i brendshëm institucional si dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet TI që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nga punonjësit e Sektorit të IT, Statistikës dhe Marrëdhënien me Publikun dhe Median, nëpërmjet e-mail-eve, komunikimeve me celular apo shkëmbimeve verbale.

➤ ***Administrimi i log-eve***

Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktiviteteve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se, GjShPJPSH nuk disponon ndonjë rregullore apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e loge-ve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, dhe për pasojë këto detyra specifike mbi analizimin dhe gjurmimin elektronik të tyre nuk janë adresuar në pozicione specifike, sipas praktikave më të mira, si dhe standardeve të sigurisë. Gjithashtu referuar dhe shkresës nr. 5396/1 prot., datë 27.10.2023 të KLGJ protokolluar me nr. 1763 prot., datë

30.10.2023 në GjShPJPSH ku dërgohen rekomandimet e AKCESK për marrjen e masave të sigurisë kibernetike, ku një ndër masat është dhe analizimi i log-eve të trafikut në rrjetin e brendshëm, nëpërmjet pajisjeve për aq sa është e mundur. Rregullorja duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

➤ **Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet**

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001, si dhe Vendimit nr. 14, datë 19.12.2022 të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë “Për Miratimin e Standardeve të Ndërtimit dhe Administrimit të Dhomës së Serverave Për Sistemin e Drejtësisë”.

Nisur nga fakti që infrastruktura e dhomës së serverëve është vendi ku sistemet informatike të qendëruara ruhen dhe ofrohen për shërbime të brendshme dhe të jashtme të institucionit, përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të sektorit të IT, Statistikës dhe Marrëdhënien me Publikun dhe Median, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e dytë të GjShPJPSH-ër dhe aksesin në rrjet.

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave dhe infrastrukturës network në GjShPJPSH, u konstatuan disa problematika si mëposhtme:

- Nuk ka një rregullore/procedurë të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Sistemi i akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar nuk është i aktivizuar;
- Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik.
- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- Nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike e plotë, e përlogaritur për pesha e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pende në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbytje;
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës;
- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- U konstatua mungesa e kamerave të sigurisë në dhomën e serverëve për monitorimin e hyrje-daljeve dhe veprimtarisë brenda në sallë.

Figura. nr. 3: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve në godinën qendrore të GjShPJPSH-ër dhe aseteve të ndodhura në të



Burimi: Grupi i Auditimit

➤ **Procedura e backup-it**

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se në GjShPJPSH specialist i teknologjisë së informacionit kryen backup periodik ditor të dhënave sensitive, databazës së sistemit ICMIS, të dhënat e sistemit audio RDA, si dhe arkivit qendror të transfertës së gjyqtarëve, specifikisht:

Incremental backup ne orën 10:00;

Incremental backup ne orën 13:30;

Incremental backup ne orën 16:00

Incremental backup ne orën 18:00;

Full backup ne orën 19:00.

Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e GjShPJPSH.

❖ **Funksionalitetet e faqes web:** <https://gjykata.gov.al/gjykata-e-shkallës-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-shkodër/gjykata-e-shkallës-së-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-shkodër/statistika/cështje-civile/>.

Nga këndvështrimi teknik portali web (Portali i Gjykatës Kombëtare) menaxhohet nga njësia e IT-së së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përmbajtja për secilën gjykatë mbahet nga stafi i gjykatave dhe përmes një CMS²-je të dedikuar. Përmbajtja e faqes web për sesionin e GjShPJPSH-ër është përgjegjësi e saj për të shtuar, modifikuar dhe fshirë informacionin.

Tek sesioni Statistika janë opsionet për statistika rreth:

- Çështje civile;
- Çështje Penale;
- Kohëzgjatja e Çështjeve;
- Vepra Sekondare dhe Dënime me Kusht;

² Content Management System

- Dhuna.

Nga auditimi i funksionaliteteve të faqes web për sesionin Statistika u konstatua se:

- Çështje civile: [Evidenca statistikore për çështjet civile gjatë periudhës:](#) - nuk shfaqet asnjë informacion si dhe nuk gjenerohet asnjë raport, për asnjë periudhë të përzgjedhur. Gjithashtu faqja ngelet për një kohë të gjatë në statusin ‘Loading..’ dhe nuk shfaqet asnjë informacion i kërkuar.

Cështje Civile

Periudha: Vlera:

Viti:

1 of 1 Find | Next

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm
Shkodër

Evidenca statistikore per çështjet civile gjate periudhes: Gjashtemujore - 6-mujori I - 2024

| Cështja civile | Dinamika | | | Menyra e perfundimit | | | | | | Shpejtësia e gjyqimit | | | Ankimime | | | | | |
|--------------------|--------------|--------------------|-----------------------|----------------------|--------|---------|--------------------|--------|---------|-----------------------|------------|--------------|----------|----------|------------|----------------------|-------------------|----|
| Lidhja e çështjeve | Të mbledhura | Të ardhura të reja | Të ardhura për prirje | Të gjyruara | Shtesa | Prenuar | Zgjidhjen e pajtim | Kaluar | Pulhuar | Të gjyruara | Perfunduar | Papërfunduar | 0-2 muaj | 2-6 muaj | Mbi 6 muaj | Çështje të ankimuara | Më pak se ankimet | |
| 1 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |

Cështjet Penale

Periudha: Vlera:

Viti:

1 of 1 Find | Next

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm
Shkodër

Evidenca statistikore per çështjet penale gjate periudhes: 6-mujori II 2024

| Vepra penale | | Dinamika | | | | Te Perfunduara | | | | | | Shpejtësia e gjyqimit | | | | | | | |
|--------------|---|--------------------------|----------------------|-----------------|---------------------|----------------------|-------------|----------|---------------------|-------------------|-------------------|-----------------------|---------------|-------------|----------|----------------|------------------|-------------|----|
| Neni | | Emetimi i veprave penale | Çështje të mbledhura | Çështje të reja | Çështje të gjykuara | Çështje të shprehura | Të gjyruara | Gjithesë | Vendim i plotësisht | Vendim i pjesshëm | Vendim i pjesshëm | Plebish i hehmi | Moskompetence | Të gjyruara | Gjithesë | Dori në 2 Muaj | 2 deri në 6 muaj | 6 - 12 muaj | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |

- Çështje Penale: [Evidenca statistikore për çështjet penale gjatë periudhës:](#) nuk shfaqet asnjë informacion si dhe nuk gjenerohet asnjë raport, për asnjë periudhë të përzgjedhur.

- Kohëzgjatja e Çështjeve: Për periudha të ndryshme të selektuara shfaqet i njëjti informacion si më poshtë:

Kohëzgjatja e Cështjëve

Deri ne daten: 2/5/2024 12:00:00 AM

REPUBLICA E SHQIPERISE
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkoder

Ceshtje te paperfunduara deri ne daten: 2/5/2024

| Kohëzgjatja (në dite) | Numri i çështjeve | Percqindja |
|-----------------------|-------------------|------------|
| 1 deri ne 60 | 455 | 25.13% |
| 61 deri ne 120 | 377 | 20.06% |
| 121 deri ne 180 | 93 | 4.95% |
| 181 deri ne 240 | 116 | 6.17% |
| 241 deri ne 300 | 104 | 5.53% |
| 301 deri ne 360 | 91 | 4.84% |
| 361 deri ne 420 | 45 | 2.39% |
| 421 deri ne 480 | 51 | 2.71% |
| 481 deri ne 540 | 49 | 2.61% |
| 541 deri ne 600 | 29 | 1.54% |
| 601 deri ne 660 | 25 | 1.33% |
| 661 deri ne 720 | 35 | 1.86% |
| 721 ose me shume | 429 | 22.83% |

Totali i Ceshtjeve: 1879

Kohëzgjatja e Cështjëve

Deri ne daten: 4/17/2025 12:00:00 AM

REPUBLICA E SHQIPERISE
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkoder

Ceshtje te paperfunduara deri ne daten: 4/17/2025

| Kohëzgjatja (në dite) | Numri i çështjeve | Percqindja |
|-----------------------|-------------------|------------|
| 1 deri ne 60 | 455 | 23.15% |
| 61 deri ne 120 | 377 | 20.06% |
| 121 deri ne 180 | 93 | 4.95% |
| 181 deri ne 240 | 116 | 6.17% |
| 241 deri ne 300 | 104 | 5.53% |
| 301 deri ne 360 | 91 | 4.84% |
| 361 deri ne 420 | 45 | 2.39% |
| 421 deri ne 480 | 51 | 2.71% |
| 481 deri ne 540 | 49 | 2.61% |
| 541 deri ne 600 | 29 | 1.54% |
| 601 deri ne 660 | 25 | 1.33% |
| 661 deri ne 720 | 35 | 1.86% |
| 721 ose me shume | 429 | 22.83% |

Totali i Ceshtjeve: 1879

- Vepra Sekondare dhe Denime me Kusht: nuk shfaqet asnjë informacion si dhe nuk gjenerohet asnjë raport, për asnjë periudhë të përzgjedhur.

Vepra Sekondare dhe Denime me Kusht

Periudha: Tremujore Vlera: 3-mujori III

Viti: 2024

REPUBLICA E SHQIPERISE
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkoder

Evidenca statistikore per veprat sekondare gjate periudhes: 3-mujori III 2024

| Neni | Emertimi i Vepres Penale | Veprat Sekondare | Denime me Kusht | Denime me Gjobe dhe me Burgim |
|------|--------------------------|------------------|-----------------|-------------------------------|
| | | | | |

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 272/4 prot., datë 12.08.2025 “Observacion mbi gjetjet e Projekt Raportit nr. 272/3, datë 15.07.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Referuar edhe sa është bashkëpunuar puna me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, si dhe Drejtorinë e Teknologjisë së informacionit pranë KLGJ-së rezulton se ky konstatim (gjetje) ku vihet re mospërputhja ndërmjet “Numri i Aktit” të gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik ICMIS dhe numrit të aktit të vendosur në dosjet fizike të çështjes, është e rëndësishme të saktësohet se kjo situatë nuk buron nga mangësi në funksionimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, por lidhet drejtëpërdrejtë me procedurat manuale të administrimit të dosjeve fizike nga sekretaria gjyq. ...

Përsa më sipër, do të merren masa për unifikimin e numrit të aktit në sistem me atë fizik në dosje, gjatë procesit të mbartjes duke filluar nga viti ku jemi, 2025 për 2026.

Qëndrimi i grupit të auditimit: GjShPJPSH përsa i përket moskoordinimit të ‘Nr. të Aktit’ i cili gjenerohet nga sistemi, me numrin e dosjes fizike të printuar, pranon konstatimin e grupit të auditimit dhe citon se do të vijojë në zgjidhjen e problematikave në vijimësi. Për sa më sipër konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Pretendimi i subjektit: Nga ana e Zv. Kryetares së Gjykatës në lidhje me këtë rekomandim u disponua me Urdhrin e brendshëm nr. 181, datë 31.07.2025, me lëndë “Përcaktimin e administratorit të sistemit ICMIS”. ...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket observimit të mësipërm, konstatohet se GjShPJPSH ka marrë masa për përcaktimin e administrator-it të sistemit ICMIS, si dhe

përcaktimin e detyrave të tij me urdhrin nr. 181, datë 31.07.2025. Observacioni juaj merret në konsideratë, si dhe është trajtuar duke reflektuar ndryshimet në këtë Raport Auditimi.

Pretendimi i subjektit: ...Bazuar në Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Vendimin nr. 971 dhe Vendimin nr. 972, datë 02.12.2020, kompetenca për miratimin, funksionimin, administrimin dhe mbikëqyrjes e sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë – përfshirë sistemin ICMIS i takon KLGJ në bashkëpunim me Qendrën e teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (QTI)...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa kohë ju keni qenë subjekt nën auditim, si dhe mangësitë janë konstatuar në institucionin tuaj si pjesë e sistemit të drejtësisë. Sjellim në vëmendjen tuaj se, gjatë kësaj periudhe për sistemin ICMIS që ju dispononi serverin tuaj të instaluar në nivel lokal si dhe Active Directory ku menaxhohet baza e të dhënave për këtë sistem, ju keni operuar pa një politikë apo rregullore të dokumentuar dhe miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve për sistemin ICMIS, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve etj. Për përmirësimin e situatës grupi i auditimit gjykon se GjShPJPSH duhet të marrë masa për të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit duke i adresuar ato tek institucionet përkatëse dhe kompetente ashtu sikurse dhe ju citoni, me qëllim përmirësimin dhe funksionimin e të gjitha proceseve të punës në një sistem të informatizuar për gjykatën Shkodër.

Pretendimi i subjektit: Raportet statistikore në sistemin ICMIS janë të aksesueshme nga të gjithë përdoruesit e autorizuar të sistemit, pa kufizim funksional nga vetë platforma. ..., çdo mospërputhje e mundshme në statistika buron jo nga një problem teknik apo mangësi e sistemit, por nga aspektet organizative dhe inputet njerëzore që lidhen me hedhjen e të dhënave në sistem. ... Në të tilla kushte nga ana e eprorëve administrativ të gjykatës do merren masa për t’i dhënë zgjidhjet e duhura në nivel organizativ dhe burimesh njerëzore, duke i kërkuar përdoruesve që ushqejnë sistemin me të dhëna të sakta në hedhjen e tyre. Lidhur me opsionet në sistem të cilat pretendohet se “nuk kryejnë asnjë funksion”, sqarojmë se termat “nuk funksionon” dhe “nuk përdoret” janë konceptualisht të ndryshëm. Në vlerësimin tonë prania e disa funksioneve që nuk përdoren aktualisht nuk do të thotë se ato janë jofunksional. ...

Sa i përket konstatimit në pikën 10/2 në vlerësimin tonë nuk qëndron. Gjykata në kuptimin e saj kushtetues dhe GjShPJPSH si subjekt disponon në përputhje me K.Pr.C dhe K.Pr.P me vendime përfundimtare dhe jo përfundimtare. ... Në lidhje me pretendimin e dublimit, Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave Gjyqësore për GjShPJPSH, grumbullon vetëm të dhëna gjyqësore në rastin konkret çështje që rregjistrohen dhe përfundojnë me një vendim përfundimtar apo jo, nga gjyqtarët e caktuar për të gjykuar pranë kësaj gjykate d.m.th çështjet që i përkasin vetëm kësaj gjykate dhe nuk ka se si një çështje e regjistruar pranë kësaj gjykate të transferohet elektronikisht pranë një gjykate tjetër...

Në lidhje me çështjen e saktësisë së të dhënave gjyqësore, duhet theksuar se sistemi nuk ndërvepron me institucione të tjera shtetërore, për shkak të parimit të pavarësisë kushtetuese të gjykatave. ...

Nga ana e Zv. Kryetares së Gjykatës në lidhje me këtë rekomandim u disponua me Urdhrin e brendshëm nr. 182, datë 31.07.2025, me lëndë; “Për saktësinë e të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e parashtruara janë në tërësi shpjeguese, si dhe janë përsëritje të një pjese të konsiderueshme të konstatimeve nga grupi i auditimit.

Përsa i përket opsioneve të cilat ju shpreheni se nuk përdoren dhe nuk do të thotë se ato janë jofunksionale, sjellim në vëmendjen tuaj se përsa kohë nuk përdoren dhe nuk dihet mënyra e përdorimit të tyre nga punonjësit e vetë gjykatës nuk mund të pohoni ose mohoni

vërtetësinë e funksionimit të tyre. Gjithashtu përsa kohë një funksionalitet shfaqet në sistem supozohet të jetë funksional si dhe ka një kosto investimi për atë shërbim. Përsa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Sjellim në vëmendjen tuaj se grupi i auditimit i referohet vetëm çështjeve të cilat në vazhdimësi rezultojnë se nuk janë kompetencë e GjShPJPSH dhe që janë regjistruar në sistem nga ana juaj. Ashtu sikurse dhe ju pretendoni mbasi çështja është mbyllur me gjithë elementët e tjera të mbylljes së një çështje të njëjtë si me ato përfundimtare, sqarojmë se këto çështje më pas do të kalojnë në një tjetër gjykatë kompetente nga ku marrin një numër të ri çështjeje, si dhe pjesa e dublimit lidhet me dublimin e këtyre çështjeve për aq sa ju keni regjistruar në sistem, me çështjet që gjykata kompetente do të hedhë në sistemin e saj lokal, duke sjellë gjenerim statistikor të përgjithshëm të pasaktë për gjykatat. Përsa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Ashtu sikurse dhe grupi i auditimit ka konstatuar se sistemi ICMIS nuk ndërvepron me sisteme të tjera, sjellim në vëmendjen tuaj se, nga testimet si dhe intervistat e zhvilluara gjatë fazës së terrenit me personat përgjegjës ka rezultuar se sistemi ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke marrë si input dhe të dhëna të pasakta të cilat mund të hidhen dhe gabimisht. Duke marrë në konsideratë ngritjen e urdhrin nr. 182, datë 31.07.2025 “Për saktësinë e të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”, të Zv. Kryetares së Gjykatës, GjShPJPSH si përdorues i sistemit duhet të adresojë tek KLGJ si administrator i sistemit, përsa është konstatuar më sipër me qëllim ofrimin e zgjidhjes për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për validimin e inputit në sistem.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me këtë pikë sqarojmë se: Aksesi nga shumë përdorues i një llogarie vjen për shkak se çështja gjyqësore lidhet me gjyqtarin juridikisht (që prej shortimit të saj) dhe sekretarja mund të jetë e ndryshueshme sipas rastit, ndërkohë që elektronikisht çështja lidhet me gjyqtarin dhe sekretaren, pasi pranë çdo gjyqtari (llogarisë së tij) lidhet edhe sekretarja (në GMCÇ) duke mundësuar aksesin në çështjen e shortuar pranë tij edhe nga sekretarja e caktuar me urdhër për asistim të tij. ... Sigurimi i kushteve për ndryshimet e shpeshta të GMCÇ-ve së pari do sillte ngarkesë të shtuar administrative të gjykatës duke tejkaluar mundësinë për të siguruar mirëadministrimin e veprimtarisë kyç të gjykatës si dhe mosfillimit në kohë të seancave gjyqësore të planifikuara. Së dyti, ndryshimi i sekretares gjyqësore në një gjykim nuk shkakton akses të paautorizuar në çështjen gjyqësore nga sekretarja zëvendësuese, pasi çdo sekretare ka funksion “sekretare gjyqësore” për Gjykatën dhe mund të aksesojë në përmbushjen e këtij funksioni pranë çdo gjyqtari ku caktohet. Në të tilla kushte, praktikisht mbetet e vështirë përmbushja e këtij rekomandimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket observimit të mësipërm, argumentet e parashtruara nga ju në lidhje me rekomandimin nr. 11 janë të paqarta në lidhje me atë çfarë është konstatuar nga grupi i auditimit në lidhje me konfigurimet e Active Directory. Sqarojmë se konfigurimet by default për Active Directory sjellin një sërë risqesh të cituara dhe në këtë Raport Auditimi, përsa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit: Nga ana e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë është bërë kërkesë për riparim të sistemit të akses kontrollit në drejtim të Sektorit të Prokurimeve përmes shkresës nr. 2212 prot., datë 26.12.2024, në lidhje me gjetjen më sipërcituar dhe nga ky sektor është përfunduar vendosja e modulit të akses kontrollit. Në këtë mënyrë ky rekomandim është zbatuar nga ana e GjShPJPSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, grupi i auditimit mbanë të njëjtin qëndrim përsa kohë nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion shoqërues që akses kontrolli është funksional dhe në gjendje pune.

Pretendimi i subjektit: Në pyetjen 9 të pyetësorit të parë Grupit i është komunikuar se rrjeti monitorohet nga ASKS në kuadër të marrveshjes që KLGJ ka me këto. Në kuadër të këtij

monitorimi ASKS paraqet pranë operatorit KLGJ vlerësimin e rrishtit të sigurisë kibernetike ku përfshihet edhe ajo në lidhje me GjShPJPSH. Në të njëjtën linjë referuar edhe në pikën nr. 5.1 Gjykata nën kujdesin, orientimin dhe aprovimin e drejtorisë përkatëse pranë KLGJ-së do të marrë masa të përgatisë apo integrojë nga ana e KLGJ-së nëse vlerësohet nga kjo e fundit një plan veprimi për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve problemeve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e gjithë procesit të ndryshimeve...

Në lidhje me këto dy rekomandime 14.1 dhe 14.2, qëndrimi i gjykatës pas konsultimit edhe me KLGJ-ën është: Siç është sqaruar dhe në rekomandimi nr. 8, bazuar në Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Vendimin nr. 971 dhe Vendimin nr. 972, datë 02.12.2020, kompetenca për miratimin, funksionimin, administrimin dhe mbikëqyrjes e sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë – përfshirë sistemin ICMIS i takon KLGJ në bashkëpunim me Qendrën e teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (QTI)...

Megjithatë kryhen backup incremental çdo dy orë dhe backup të plotë ditor.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa kohë mangësitë janë konstatuar në institucionin tuaj si pjesë e sistemit të drejtësisë, sjellim në vëmendjen tuaj se, për periudhën e audituar, GjShPJPSH nuk ka disponuar një procedurë për administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI.

Në lidhje me procedurën e ndjekur për kryerjen e backup grupit të auditimit nuk i është vendosur një dokument administrativ ku të ishte e përcaktuar mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e GjShPJPSH.

Për përmirësimin e situatës grupi i auditimit gjykon se GjShPJPSH duhet të marrë masa për të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit duke i adresuar ato tek institucionet përkatëse dhe kompetente ashtu sikurse dhe ju citoni, me qëllim përmirësimin dhe funksionimin e të gjitha proceseve të punës në një sistem të informatizuar për gjykatën Shkodër. Përsa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me këtë rekomandim nga ana e Gjykatës ka filluar puna për kthimin e dhomës së serverit në përputhje me standartet e miratuara me vendim të Bordit të QTI-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nisur nga fakti që Gjykata ka filluar punën për kthimin e dhomës së serverit në përputhje me standartet e miratuara me vendim të Bordit të QTI-së, përsa i përket konstatimeve të grupit të auditimit, ju sqarojmë se ato duhet të mbahen në konsideratë për t’u zgjidhur me përmirësimin e ambienteve të dhomës së serverave.

Pretendimi i subjektit: Është e vërtetë që nga Seksioni Statistika nuk ka gjeneruar të dhëna por faqja web në momente të ndryshme nga komunikimi me kompaninë e suportit K. dhe departamentin e IT pranë KLGJ problematika është zgjidhur dhe gjeneron të dhëna statistikore për vitin aktual. ...

Pavarësisht mosfunksionimit të këtij sesioni, GjShPJPSH përmes Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Jashtë dhe Specialistit për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median si dhe Specialistin IT, që menaxhon bashkërisht me këtë të fundit faqen zyrtare janë kujdesur që të dhënat statistikore të GjShPJPSH të jetë të dhëna të aksesueshme nga çdo përdorues i faqes zyrtare të kësaj gjykate, duke i përfshirë këto të dhëna në sesionin “Të dhëna të Hapura”, në Sesionin “Programi i Transparencës”. Në këtë kuptim mos funksionimi i sesionit “Statistika gjyqësore” nuk ka cënuar mundësinë e publikut për të marrë informacion në lidhje me të dhënat statistikore të gjykatës të përgatitura si në përputhje me format raportet e KLGJ-së ashtu edhe ato të Ministrisë së Drejtësisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ashtu sikurse observoni dhe ju, që Seksioni Statistika nuk ka gjeneruar të dhëna si dhe problematika është zgjidhur dhe gjeneron të dhëna statistikore për vitin aktual, referuar dhe testimëve përmes faqes së web-it ky sesion gjeneron vetëm të dhëna për vitin aktual. Duke marrë në konsideratë punën e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Jashtë duke i përfshirë këto të dhëna në sesionin “Të dhëna të Hapura”, në Sesionin “Programi i Transparencës”, konstatimi mbi funksionalitetet e sesionit ‘Statistika’ lidhet me nevojën për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të këtij sesioni përsa kohë është në funksion dhe shfaqet për qytetarër, me çdo informacion përkatës sipas specifikave të tij, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

IV. REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka miratuar një strategji institucionale, si dhe nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Mungesa e strategjisë sjell pasoja dhe rreziqe të ndryshme, në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve, përdorimit joefikas të burimeve njerëzore, humbje të besimit nga qytetarët, humbjes së vizionit afatgjatë, etj. Gjithashtu, u konstatua se Teknologjia e Informacionit dhe përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. GjShPJPSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave që normojnë proceset e teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore rregullat dhe politikat e përgjithshme si dhe praktikatat më të mira.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 10-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie institucionale në të cilën të integrojë edhe komponentët e teknologjisë së informacionit, si një faktor mbështetës për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të marrë masa për hartimin e rregulloreve dhe procedurave mbi Teknologjinë e Informacionit, vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme të funksionimit të saj.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në dosjet personale të punonjësve mungojnë përshkrimet e punës të miratuara sipas pozicionit përkatës për kryerjen e detyrave funksionale bazohen vetëm në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe

përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”, në kundërshtim me Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 10-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për plotësimin dhe miratimin e përkrahjeve të punës për punonjësit në funksion të përmbushjes së objektivave të veprimtarisë gjyqësore të gjykatës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka të hartuar dhe miratuar rregullore të brendshme në të cilën të përcaktohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë institucionale, si dhe detyrat funksionale të punonjësve duke përfshirë edhe teknologjinë e informacionit, kjo jo në përputhje me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përkrahimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 10-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të brendshme në funksionim të përmbushjes së veprimtarisë institucionale.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk disponon regjistër rrisht për teknologjinë e informacionit, në asnjë formë nuk rezulton të jenë dokumentuar rrisht të identifikuar për periudhën e audituar. Kjo në kundërshtim me nenin 11, pika 2, nenin 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të rrishtit në njësitë publike”. Kjo sjell mungesë të identifikimit dhe adresimit të problematikave potenciale, si dhe rrisht rrisht për shkelje në fushën e sigurtisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 10-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës të rrishtve, duke përfshirë elemente të Teknologjisë së Informacionit, me qëllim analizimin, vlerësimin e tyre dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për çështjet që janë regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) atributi ‘Nr. i Aktit’ i cili gjenerohet automatikisht nga sistemi dhe që duhet të shënohet manualisht dosjes së çështjes së printuar nuk korrespondon me numrin që i vendoset dosjes fizike së çështjes. Hedhja e këtij numri bëhet manualisht duke shënuar për çdo dosje fizike numrin progresiv sipas numrit të çështjeve që trajton secili gjyqtarë, situatë kjo e cila sjellë moskoordinim të dosjeve fizike me dosjet elektronike në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe mos gjurmueshmëri për secilën çështje, mangësi kjo që vjen nga mungesa e rregullores së brendshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për rakordimin e numrit të aktit, me numrin e çështjes për çdo dosje të cilat gjenerohet nëpërmjet sistemit, për të rrisht gjurmueshmërinë dhe saktësinë e tyre në procesin e informatizuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit ICMIS u konstatua se GjShPJPSH:

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë së fjalëkalimeve të përdoruesve të sistemit ICMIS, si dhe nuk janë zbatuar kritere që forcojnë fjalëkalimet, si përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK. Gjithashtu, fjalëkalimet e secilit përdorues të sistemit ICMIS ndryshohen vetëm nga administratorët e sistemit, atëherë në rastet kur kërkohet nga vetë përdoruesi, pasi asnjë përdorues nuk ka mundësi për ndryshimin e fjalëkalimit të tij, situatë e cila sjell risk mbi sigurinë e fjalëkalimeve të përdoruesve.
- Çdo përdorues në sistem ka akses në të gjithë modulet e sistemit konkretisht dhe tek moduli i Administrimit dhe Përcaktimit ku janë panele për administratorin e sistemit, si dhe jo sipas rolit të përcaktuar që ai përdorues ka, kjo situatë sjell risk në akses në të dhëna dhe kryerjen e veprimeve në sistem nga përdorues të pa autorizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënien me Publikun dhe Median dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, të marri masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve/manualeve të përdorimit dhe funksionimit të sistemit, për pasqyrimin e saktë të detyrave, të drejtave dhe përgjegjësisve, për të dokumentuar e aplikuar politikat e sigurisë për përdoruesit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet sipas përcaktimeve rregullatore të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionaliteteve të roleve në sistemin ICMIS konstatohet se:

- Nuk ekziston një përdorues/rol në sistem me qëllim gjenerimin e statistikave përkatëse nga sistemi që gjykata raporton në KLGJ apo institucione të tjera. Konstatohet se sektori i statistikave përdor user-in e 'sekretares' me qëllim gjenerimin e statistikave nga sistemi ose statistikat për gjykatën i realizon manualisht në raste kur ka diferenca ose mos koordinim me sistemin;
- Fushat të cilat nuk janë të detyrueshme për tu plotësuar pothuajse në shumicën e rasteve janë lënë bosh, si për çështjet që regjistrohen ashtu dhe për të dhënat e secilit përdorues të sistemit duke lënë hapësirë për mos përdorimin e sistemit me të gjitha funksionalitetet e krijuara në të;
- Data e largimit të punonjësve të cilët janë larguar nga gjykata është lënë e paplotësuar për të gjithë punonjësit e larguar, për shkak se sistemi nuk identifikon më çështjet e trajtuar nga ai punonjës dhe të gjitha çështjet e atij përdoruesi nuk gjenerohen më nga sistemi;
- Roli 'Arkivit' nuk përdoret nga asnjë punonjës i gjykatës;
- Tek opsioni i Akuzave, ka akuza të cilat sistemi nuk i ka të regjistruara me qëllim selektimin e tyre, e për pasojë shtohen nga regjistruesja manualisht me komentin përkatës;
- Tek sesioni 'Kategoria e Çështjes' nuk është shtuar opsioni 'I mitur në konflikt me Ligjin' në sistem, ky opsion shtohet më pas manualisht tek sesioni 'Palët';
- Ekzistojnë opsione të cilat nuk kryejnë asnjë funksion në sistem si prsh., 'Numër Akti Regjistër', ose Opsione në modulet kryesore si:
 - o Moduli 'Administrimi' ka sesione të cilat nuk përdoren si: 'Mesazhe Specifike', 'Ditë Pushimi', 'Lejet e Punonjësve', 'Eksport', 'Kërkim në Serverin Qendror', 'Transfero në Serverin Qendror' dhe 'Anullo Mbartje';
 - o Moduli 'Përcakto' ka sesione të cilat nuk përdoren si: 'Lista e Kontrollit', 'Mesazhe' dhe 'Numërtimi i Vendimeve'.
- Asnjë nga çështjet e trajtuara në sistem nuk arkivohen dhe nuk shfaqet asnjë informacion për statusin e çështjeve 'të arkivuara'.
- Moduli 'Arkiva e çështjeve' nuk funksionon si dhe shfaq informacionin 'Gabim i paparahikuar. Ju lutem mos bëni asnjë veprim...';

- Vendimet të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi nuk janë sipas formateve të vendimit, duke kërkuar kryerjen e veprimeve manualisht me qëllim minimizimin e gabimeve sipas formatit që gjeneron sistemi;

- Kanë rezultuar probleme me funksionalitetet e filtrave në sistem në lidhje me kërkimin mbi çështje të ndryshme, pasi filtri sipas një numri të caktuar jep të gjitha çështjet që përmbajnë një nga numrat e vendosur në filtër, duke mos ofruar rezultatin e kërkuar;

- GjShPJPSH nuk ka regjistruar asnjë avokat dhe ekspertë sipas zhvillimeve të bëra në sistemin ICMIS si dhe manualet e përdorimit me qëllim njoftimin elektronik të tyre nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga palët, avokatët dhe ekspertët.

Problematikat mbi funksionalitetet e sistemit sjellin pamundësi për të punuar nëpërmjet sistemit për shkak të mangësive të konstatuara, të cilat pengojnë veprimet operacionale të përdoruesve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për adresimin e parregullsive në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si administrator i sistemit, në lidhje me përmirësimin, rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi, si dhe të gjitha rastet që do të konsiderohen si anomali të sistemit me qëllim saktësimin, plotësimin dhe sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit nëpërmjet sistemit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, sesionet ‘Pagesa’, ‘Pagesat e mëparshme’, ‘Listë Kontrolli’, nuk janë funksionale dhe nuk kryejnë asnjë funksion nëpërmjet sistemit, gjithashtu sesioni ‘Printo’ është një opsion i cili nuk përdoret nga punonjësi i cili gjeneron statistikën. Nga komunikimet dhe pyetësit me personat të cilët merren me gjenerimin e statistikave kritere të rëndësishme në raportimet që ato bëjnë janë ‘Tipi i Dispozitivit’, ‘Data e Shortimit’, si dhe ‘Baza Ligjore e Padisë’ për të cilat të gjitha rastet e gjeneruar kontrollohen dhe identifikohen manualisht me qëllim gjenerimin e raportimeve informative.

Nga auditimi mbi çështjet që janë regjistruar në sistem dhe në vijimësi rezultojnë se nuk janë në kompetencë të GjShPJPSH, konstatohet se për këto çështje nuk ka një opsion identifikues në sistem me qëllim mbylljen e tyre si moskompetencë e gjykatës, por për atë çështje të regjistruar si rekord në sistem bëhet një vendim dhe dispozitiv fiktiv me qëllim mbylljen e çështjes me të gjitha elementët e mbylljes. Më pas këto çështje kalojnë në një tjetër gjykatë kompetente nga ku marrin një numër të ri çështjeje pasi regjistrohen në sistem, duke sjellë dublim të këtyre çështjeve për aq sa janë regjistruar në sistem nga ana e GjShPJPSH me çështjet që gjykata kompetente do të hedhë në sistemin e saj lokal, duke sjellë gjenerim statistikor të përgjithshëm të pasaktë për gjykatat nëpërmjet sistemit.

Gjithashtu nga analizimi i të dhënave, rezultoi se sistemi ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të pasakta. Konstatohet se vërtetimet për personat që kanë proces gjyqësor të hapur në gjykatë (nuk kanë marrë një vendim apo dispozitiv përfundimtar), për persona fizik dhe juridik vazhdojnë të realizohen manualisht në mënyrë opsionale në word nga kryesekretaret e institucionit, pasi ekziston risku i të dhënave të hedhura gabimisht në sistem duke qenë se sistemi nuk ndërvepron me sisteme të tjera si DPGJC me qëllim gjenerimin e të dhënave të sakta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të adresojë tek Këshilli i Lartë Gjyqësor, parregullsitë për krijimin e mekanizmave të nevojshëm, shtimin e kritereve të rëndësishme në raportimet që GjShPJPSH kryen, implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit në sistem, si dhe automatizimin e plotë të

shërbimit nëpërmjet sistemit, me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit dhe gjenerimin e statistikave të sakta.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se konfigurimet e Active Directory janë lënë në gjendjen *by default* dhe nuk janë përshtatur sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Politikat e sigurisë që lidhen me fjalëkalimet, të drejtat e përdoruesve, parametrat e sigurisë dhe elementë të tjerë kritikë, rezultojnë të jenë në gjendjen fillestare të vendosur nga sistemi në momentin e implementimit. Këto politika duhet të konfigurohen në përputhje me nivelin e rëndësisë dhe rrezikshmërisë së tyre, në mënyrë që të forcohet siguria e aksesit dhe mbrojtja e infrastrukturës IT.

Disa nga risqet që vijnë si rezultat i konfigurimeve default i active directory janë:

- Ekziston rreziku i mos menaxhimit të politikave që mund t'i lejojë përdoruesit të marrin shumë të drejta;
- Rreziku që politikat e fjalëkalimit nuk janë në përputhje me praktikën më të mira, kjo mund ta bëjë më të lehtë për personat e paautorizuar qasjen në rrjet dhe sisteme;
- Fjalëkalimet që nuk skadojnë kurrë mund të rezultojnë në akses të paautorizuar. Ky është veçanërisht një rrezik nëse ka llogari të përbashkëta përdoruesish ose llogari të sistemit me privilegje administratori. Kështu, ish-punonjësit mund të abuzojnë me këto të drejta;
- Llogaria e një përdoruesi me një fjalëkalim bosh mund të rezultojë në akses të paautorizuar, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për analizimin e situatës mbi konfigurimin e politikave të sigurisë së Active Directory dhe ti përshtatë ato në përputhje me standardet, për rritjen e nivelit të sigurisë së aksesit dhe standardizimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në hyrjen kryesore në godinën e GjShPJPSH rezulton një sistem aksesi për hyrje-daljet e punonjësve të GjShPJPSH, i cili është jashtë përdorimit nga stafi me qëllim monitorimin e lëvizjeve dhe hyrje daljeve, gjë e cila kompromenton nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet fizike të GjShPJPSH, duke mbartur riskun e aksesit të paautorizuar në ambientet fizike të GjShPJPSH, mangësi kjo që vjen edhe nga mungesa e rregullores së brendshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për përdorimin dhe monitorimin e sistemit të aksesit hyrje-dalje nga i gjithë stafi i institucionit me qëllim rritjen e sigurisë në ambientet fizike të saj.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, GjShPJPSH nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI, sipas praktikave dhe standardeve më të mira. Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh, ku suporti dhe komunikimi i brendshëm institucional si dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet TI që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nga punonjësit e Sektorit të IT, Statistikës dhe Marrëdhënien me Publikun dhe Median, nëpërmjet e-mail-eve, komunikimeve me celular apo shkëmbimeve verbale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve, për njohjen dhe minimizimin e riskut të incidenteve që të cilat

sjellin humbje, tjetërsim apo transferim të informacionit konfidencial që akseson dhe administron institucioni në përputhje me aktivitetin e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit u konstatua se, GjShPJPSH nuk disponon rregullore apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e loge-ve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, duke mos adresuar detyrat e analizimit dhe gjurmimit elektronik në pozita specifike, sipas praktikave më të mira, si dhe standardeve të sigurisë, situatë kjo e cila sjellë humbje të të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve. Rregullorja duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e GjShPJPSH, kjo situatë përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, nga dëmtimi, humbja apo komprometimi i tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të marrë masa për hartimin e një akti rregullativ për administrimin e gjurmëve elektronike mbi pajisjet dhe sistemet që i shërbejnë monitorimit dhe auditimit, duke specifikuar qartë pajisjet dhe sistemet për të cilat do të ruhen gjurmë elektronike, vendi ku do të ruhen, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë si dhe çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

12.2 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për hartimin dhe miratimin e procedurës së ndjekur për kryerjen e backup ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve dhe procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet që ka në përdorim.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Gjatë vizitës së kryer nga grupi i auditimit në dhomën e serverëve dhe infrastrukturës së rrjetit në GjShPJPSH, u evidentuan problematikat si më poshtë:

- Sistemi i akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar nuk është i aktivizuar;
- Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik.
- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- Nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike e plotë, e përllogaritur për pesha e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pënde në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbajtje;
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës;
- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- U konstatua mungesa e kamerave të sigurisë në dhomën e serverëve për monitorimin e hyrje-daljeve dhe veprimtarisë brenda në sallë;

- Nuk ka një rregullore/procedurë të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve.

Problematikat e konstatuar në dhomën e serverëve dhe në infrastrukturën e rrjetit të GjShPJPSH, si pasojë e moszbatimit të bazës rregullatore mbi standardet dhe sigurinë fizike, sjellin risk në mosgarantim të vazhdimësisë së punës si dhe risk për thyerje të sigurisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masa për përmirësimin e ambienteve të dhomës së serverave, në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për shmangien e shkeljes së sigurisë, humbjes së informacionit, shkatërrim të aseteve dhe mos garantimi i vazhdimësisë së punës.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionaliteteve të faqes web për sesionin Statistika u konstatua se:

- Çështje civile: Evidenca statistikore për çështjet civile gjatë periudhës: - nuk shfaqet asnjë informacion, si dhe nuk gjenerohet asnjë raport, për asnjë periudhë të përzgjedhur. Gjithashtu faqja ngelet për një kohë të gjatë në statusin ‘Loading.’ dhe nuk shfaqet asnjë informacion i kërkuar.

- Çështje Penale: Evidenca statistikore për çështjet penale gjatë periudhës: nuk shfaqet asnjë informacion, si dhe nuk gjenerohet asnjë raport, për asnjë periudhë të përzgjedhur.

- Kohëzgjatja e Çështjeve: Për periudha të ndryshme të selektuara shfaqet i njëjti informacion;

- Vepra Sekondare dhe Denime me Kusht: nuk shfaqet asnjë informacion si dhe nuk gjenerohet asnjë raport, për asnjë periudhë të përzgjedhur.

Problematikat mbi funksionalitetet e faqes web sjellin pamundësi për të aksesuar informacionin nga qytetarët, si dhe mos gjenerimin e të dhënave statistikore për çështjet e sipërcituara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes web, të marrin masa për përmirësimin dhe përditësimin e saj me informacionet përkatëse për të rritur transparencën ndaj qytetarëve.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT